



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201501098/16

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** Rekomandohet "Fillimi i hetimit për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" ndaj punonjësve të policisë të Strukturave Speciale Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në dëm të shtetasve E. P., D. G., D. B., etj, nga Lazarati, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

**Drejtuar :** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z.Arben PASHO

**GJIROKASTËR**

**Për dijeni:** Prokurorit të Përgjithshëm  
Z. Adriatik LLALLA

**TIRANË**

*I nderuar Z. PASHO,*

Avokati i Popullit mbi bazën e artikullit të gazetës Lapsi.al të datës 27 Qershor 2015, "Dhunohen nga policia, përfundojnë në spital dy të ndaluar në Lazarat" ka filluar me inisiativë rastin për keqtrajtim nga punonjësit e policisë të Strukturave Speciale Operacionale, në dëm të shtetasve E. P., D. Gaba., etj, banues në Lazarat të Gjirokastrës. Mbi këtë shqetësim është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, cili është realizuar me shkuarjen në vënd të dy Ndhimëskomisionerëve të Avokatit të Popullit.

Në vijim të hetimit administrativ janë kryer një sërë veprimesh të cilat kanë konsistuar në marrjen e shpjegimeve të shtetasve të dëmtuar E. P., D. Gaba., D. B., etj; janë marrë deklarime shtetasve që kanë dijeni për rastin në shqyrtim si S. P., dhe P. P.; janë administruar kartelat klinike për shtetasit E. P., dhe D. G., nga Spitali Rajonal "Omer Nishani" në Gjirokastrë si dhe në Spitalin e Traumës Tiranë; janë përpiluar kërkesat për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor

drejtuar IML Tiranë dhe janë administruar aktet e ekspertimit mjeko ligjor nr.1298 datë 20.07.2015, për shtetasin e dëmtuar E. P., dhe akti mjeko ligjor me nr.1302 për shtetasin e dëmtuar D. G., etj.

### **Rrethanat e ngjarjes**

Rasti lidhet me operacionin e kryer nga forcat e Strukturave Speciale Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, në datat 26 dhe 27 Qershor 2015, gjatë aksionit për kapjen e personave të dyshuar pas ngjarjes kriminale të vrasjes së punonjësit të policisë të repartit “RENEA”, të ndjerit I. B., si dhe plagosjes së dy kolegëve të tij, datë 24.06.2015.

Shqetësimi i shtetasve, banorë të Lazaratit ka konsistuar në faktin se punonjësit e policisë kanë kryer veprime abuzive dhe arbitrare në tejkalim të kompetencave si, gjatë ushtrimit të kontrollit të banesave ashtu dhe në përdorimin e dhunës fizike në cënim të shëndetit dhe dinjitetit njerëzor. Nga përdorimi i dhunës së ushtruar shtetasit E. P., dhe D. G., janë dërguar në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës, ku është dhënë ndihma e nevojshme mjekësore.

### **Veprimet e kryera** **Baza për fillimin e procedimit penal**

Në shpjegimet e marra shtetasit E. P., në banesën e tij në Lazarat (ku është realizuar dhe fotografia bashkëlidhur) ai sqaron se: *“Më datë 27 Qershor 2014, rreth orës 0.6.30 kam shkuar tek gjyshi P. P., 97 vjeç, për ta ndëruar...pas pak dëgjuam zhurmë tek dera dhe pashë 15-20 policë me uniforma dhe maska. Policët më thanë duart lart ndërsa isha tek veranda. Pastaj një polic më shtriu e më vuri këmbën prapa qafe. Më vunë dhe prangat dhe më futën në një autoblindë policie. Një polic më dha ujë tek buzët pasi e pa që nuk isha mirë. Tek kthesa e Lazaratit më kanë nxjerrë nga autoblanda, më hoqën prangat dhe më çuan tek një autoambulancë ku më kanë vizituar dhe dëgjova që më thonin se ka rrahje të shpeshta zemre. Me këtë autoambulancë më kanë çuar direkt në spitalin e Gjirokastrës në urgjencë e pastaj në repartin e kirurgjisë, deri në orën 23.20. Pas kësaj, me autoambulancën e spitalit, me një polic e infermier më çuan në QSU Tiranë....dua të them se dhimbjen që kam në qafë e kam nga goditja e policëve që më vunë shqelmin në qafë....”.*

Shtetasi D. G., në shpjegimet e tij marrë më datë 30 Qershor 2015 në mjediset e IEVP “Mine Peza” Tiranë, ka sqaruar se: *“Më datën 26.06.2015, u paraqita vetë në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë, meqënëse më kishte kërkuar Policia në shtëpi. Ishte rreth orës 17.05 kur po rrija në koridorin e katit të parë të Komisarimit, erdhi një person civil i cili më qëlloi një herë në faqen e majtë duke më thënë që trego shokët e mendohu. Pastaj policët e Gjirokastrës pas 30 minutash më çuan tek koridori i dhomave të shoqërimit. Këtu erdhën tre policë jo të Gjirokastrës, të cilët më qëlluan me pëllëmbë në fytyrë e kokë e më pas rashë në dysheme, kurse një prej policëve më goditi me shqelm në kokë. Për shkak të goditjeve të tyre unë nuk ngrihesha dot dhe aty erdhi mjeku i policisë i cili më mati tensionin e pas kësaj më çuan në urgjencën e spitalit”.*

Shtetasi D. B., i pyetur më datë 30 Qershor 2015, sqaron se: *“Ditën e djelë datë 28 Qershor 2015, ora 0.5.30 kemi qënë në gjumë bashkë me gruan, nusen e djalit dhe vajzën, kur vajza V., 20 vjeç tha çohuni dhe menjëherë sa u çuam pamë 15-20 policë të “RENEAS” me maska. Më pyetën se ku e kam djalin B., duke më nxjerë dhe fotografinë e tij. I thashë se nuk e di ku është, e policët filluan të kontrollonin gjithçka në shtëpi, rroba, poshtë krevatëve, në dollape. Më pyetën për makinë që e ka djali të blerë, por pa dokumente, kurse unë ju them se keni ardhur për makinën apo për çfarë. Pas kësaj dy nga policët më qëlluan me pëllëmbë e shqelma në trup. Pastaj me forcë më hipën në makinë policie dhe më çuan në dhomë shoqërimi...”*

Në shpjegimet e saj datë 30.06.2015, shtetasja P. P., ndërmjet të tjerave sqaron se: *“Më datën 27.06.2015, ora 06.30 unë thirra nipin tim E. P., që të më ndihmonte për të ngritur babanë, i cili ishte rrëzuar nga krevati. Sapo E., hyri në banesë dhe sëbashku hipëm babanë në krevat, E., u shtri për të fjetur. Në dhomë hynë disa policë dhe babanë megjithë dyshekë e hodhën poshtë në dysheme. Policët goditën E., me shqelma në gjoks e në trup, ndërsa mua më goditën me qytë në kurriz”. (Bashkëlidhur fotografi e shtetasit P. P.,)*

Në aktin e ekspertimit mjeko ligjor nr.1298 datë 20.07.2015, tek pjesa përshkuese e rrethanave të çështjes dhe shqyrtimit të materialeve mjekësore, ndërmjet të tjerave thuhet: *“Referuar fotokopjes së kartelës klinike me numer 2019 arkive të repartit të kirurgjisë të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë, rezulton se shtetasi E. P., është paraqitur për të marrë ndihmë mjekësore pranë këtij reparti në orën 15.30 të datës 27.06.2015, dhe është shtruar me diagnozë të shtrimit, pranimi Parapareze spastike e extremiteteve inferior. Gjëndja e përgjithshme paraqitet jo e mirë. Koshienca jo e qartë...respiracion vezikular në pulmone, vështirësi motorrike të ekstremiteteve inferior. Gjëndja e përgjithshme jo e mire”. Në Spitalin e Traumës në Tiranë rezulton se shtetasi E. P., është shtruar me diagnozë të shtrimit Traumë e kolonës cervikale. Në shtrimi pacienti ankon për dhimbje të rregjionit të qafës”. Në konkluzion sipas ekspertit mjeko ligjor Dr.Elmas Shaqiri “... tek shtetasi E. P., nuk janë konstatuar në kqyrjen objektive dëmtime të jashtme në ekzaminimin scannerik të kokës dhe të kolonës si dhe në konsultën neurokirurgjikale pranë spitalit të Traumës nuk evidentohen dëmtime traumatike të kockave të kokës ruazave të kolonës apo të trurit dhe të medullës spinale (palcës kurrizore)”*

Në aktin e ekspertimit mjeko ligjor nr.1302, datë 20.07.2015, tek pjesa përshkuese e rrethanave të çështjes dhe shqyrtimit të materialeve mjekësore, ndërmjet të tjerave thuhet: *“...referuar fotokopjes së kartelës klinike me numer 2011 arkive të repartit të kirurgjisë të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë, rezulton se shtetasi D. G., është paraqitur për të marrë ndihmë mjekësore në orën 22.00 të datës 26.06.2015, dhe është shtruar me diagnozë të shtrimit dhe atë të pranimi, Takikardi supraventrikulare një episode, s.contusio capithis. Në shtrimi pacienti me gjëndje të ngarkuar emocionale, dhimbje të kokës, marrje mëndsh, dobësi trupore. Ndërsa në konkluzionet e aktit mjeko ligjor thuhet: “Nga shqyrtimi i materialeve mjekësore të çështjes të vëna në dispozicion nga Zyra e Avokatit të Popullit, rezulton se tek shtetasi D. G., nuk janë konstatuar në kqyrjen objektive dëmtime të jashtme, ne*

*ekzaminimet scannerike të kokës nuk evidentohen dëmtime traumatike të kockave të kokës apo të trurit”.*

Shprehim mendimin se konkluzioni i dhënë nga eksperti mjeko ligjor, në të dy aktet mjeko ligjore, është i nxituar dhe bie ndesh jo vetëm me faktin e konstatimit të dëmtimeve e gjëndjes jo të mirë në momentin e shtrimit në spitalin Rajonal Gjirokastrë, për shtetasit E. P., dhe D. G., por dhe në konteks me aktet e administruara në dosjen e rastit. Eksperti mjeko ligjor gjithashtu nuk ka kryer ekzaminimin e personave të dëmtuar, ndonëse në kërkesën për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor është sqaruar se shtetasi E. P., banon në Lazarat, kurse D. G., në IEVP “Mine Peza” Tiranë, me masë sigurimi “Arrest në burg”. Për rrjedhojë kryerja e një ekspertimi tjetër me grup ekspertësh mjeko ligjorë dhe specialistë të fushës, do të ishte në interes të çështjes për dhënien e një konkluzioni objektiv.

Më datë 03.07.2015, me shkresën nr.K2/I27-8, i kemi kërkuar informacion Drejtorisë së Policisë të Qarkut Gjirokastrë, si për ushtrimin e dhunës ndaj shtetasit D. G., në mjediset e Policisë ashtu dhe për vënien në dispozicion të pamjeve filmike. Në përgjigjen e saj datë 08.07.2015, sipas shkresës nr.1746/1 ndërmjet të tjerave informon Institucionin e Avokatit të Popullit se: *“...pas përfundimit të procedurës për marrjen e shënjave të gishtave, pas disa minutash shtetasi në fjalë ka bërë ankesë se ndihej keq nga ana shëndetësore dhe është kërkuar ardhja e mjekut, i cili pasi e ka vizituar ka urdhëruar për ta dërguar në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës për trajtim të metejshëm shëndetësor. Përsa u përket pamjeve filmike që kërkohen nga ana e juaj, ju bëjmë me dije se sistemi ynë i kamerave ka mbi 6 muaj që nuk funksionon”.*

Më datë 03.07.2015, me shkresën nr.K2/I27-7 i kemi kërkuar informacion Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, me qëllim për të sqaruar procedurat e ndjekura nga organi i Prokurorisë dhe Policia Gjyqësore në kryerjen e kontrollit të banesave të shtetasve të sipërpërmëndur dhe bllokimin e sekuestrimit e sendeve prova materiale si, automjete, aparate celulare etj. Në përgjigjen e datës 21.07.2015, me shkresën nr.1423/1, Prokuroria e Krimeve të Rënda informon se janë zbatuar dispozitat proceduriale për kryerjen e kontrollit të banesave e sekuestrimit e sendeve prova materiale, dhe se nga personat e mësipërm nuk ka patur ankesa në këtë drejtim.

Me qëllim të kryerjes së një hetimi të gjithanshëm administrativ, më datë 03.07.2015, me shkresën nr. K2/I27-9 i kemi kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila më datë 21.07.2015, sipas shkresës nr.4350/1 ndërmjet të tjerave informon se: *“Në lidhje me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të listës me emrat e punonjësve të policisë së Strukturave Speciale Operacionale, ju bëjmë me dije se, mbështetur në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 135 pika 3, është përcaktuar shprehimisht: “Punonjësve të Strukturave Speciale Operacionale u garantohet fshehtësia e identitetit për veprime operacionale”.*

### **Mendime dhe përfundime**

Parë në tërësi veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të Strukturave Speciale Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, janë të parregullta dhe bien ndesh me nenin 5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e

Shtetit”, Parimet e Veprimtarisë pika a) ligjshmëria dhe pika c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ndërsa në nenin 133 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” i cili bën fjalë për Përdorimin e Forcës, thuhet: *“Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur ajo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasukseshme apo të pamundura”*.

Këto veprime bien ndesh me Misionin e Policisë së Shtetit, që është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, parashikuar në nenin 2 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Shteti i ka dhënë Policisë përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të shtetit ligjor. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t’i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Duke analizuar në tërësi ngjarjen me provat e administruara rezultoi se:

*Së pari:* Punonjësit e policisë të Strukturave të Forcave Speciale, në rastin e ankesave të shtetasve E. P., D. G., dhe D. B., me sjelljet e veprimet e tyre kanë tejkaluar kompetencat në ushtrimin e detyrës duke filluar nga kryerja e kontrollit të banesave në mënyrë abusive dhe deri në bllokimin dhe sekuestirimin e automjeteve apo aparateve celularë, duke mosrespektuar dispozitat procedurale për këtë qëllim. Në asnjë rast shtetasve që iu është kontrolluar banesa nuk ju është dhënë kopje e proces verbalit të kontrollit

Nga verifikimi i kryer në pikën e bllokimit të mjeteve të Komisarariatit të Policisë Gjrokastër datë 29 Qershor 2015, rezulton se janë bllokuar 11 automjete të ndryshme, por inspektorit përgjegjës të policisë Sulejman Kazma nuk i është dhënë asnjë dokument për to.(Bashkëlidhur fleta me mjetet e ardhura nga Komisarati datë 29.06.2015).

*Së dyti:* Ushtrimi i dhunës fizike është flagrante si në mjediset e Komisarariatit të Policisë Gjrokastër, rasti i shtetasit D. G., ashtu dhe në banesat e tyre ndaj shtetasve E. P., e D. B., pa bërë dallim moshe e seksi apo dhe në prani të familjarëve. Kryerja e këtyre veprimeve nga punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës i kapërthen kompetencat dhe si e tillë është e kundërligjshme me pasoja në shëndetin e qytetarëve dhe cënimin e dinjitetit njëriëzor.

Nëpërmjet kryerjes flagrante të veprimeve arbitrare të dhunshme, nga punonjësit e policisë të Strukturave Speciale Operacionale gjatë ushtrimit të detyrës, ka dyshime të arsyeshme e të bazuara se ata kanë kryer veprën penale e “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, ndaj shtetasve E. P., D. G., dhe D. B., parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

Objekti i veprave penale të mësipërme janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të rregulluar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik që kanë të bëjnë me respektimin e lirive të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Për zhvillimin e një hetimi të gjithanshëm dhe objektiv, do të sugjeronimin:

a.Kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor me grup ekspertësh të IML-së, për të sheshuar kontradiktat në dhënien e konkluzionit të akteve mjeko ligjor nr. 1298 dhe nr.1302 datë 20.07.2015, referuar dhe akteve të administruara në dosjen e rastit nr.1098 të vitit 2015 ( bashkëlidhur fotokopje të tyre).

b. Të hetohet në drejtim të pretendimeve të ngritura nga Drejtoria e Policisë Gjyrokastër se sistemi i kamerave ka mbi 6 muaj që nuk funksionon. Kjo dhe për arsyen se në datën 01.07.2015, kur nga Ndhmëskomisionerët e Avokatit të Popullit është kërkuar që të shikoheshin pamjet filmike, nga drejtuesit e Policisë janë informuar se punonjësi i IT-së ndodhej me shërbim larg në antenat e instaluar në malin e Sopotit.

Hetimi në këtë drejtim duhet të kryhet me qëllim për të sqaruar kohën, arsyen e mosfunksionimit të kamerave dhe mosmarrjen e masave për riparimin e vënien në funksionim të tyre.

c.Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është detyrimi i organit të Prokurorisë që bazuar në pikën 4 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Kur nga punonjësit e policisë së strukturave special operacionale gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, para ose pas operacionit kryhen vepra penale, ndaj tyre ndiqen procedurat ligjore si për gjithë shtetasit e tjerë”*, që të marrë deklarime të punonjësve të policisë si persona të dyshuar në kryerjen e veprës penale *“Kryerja e veprimeve arbitrare”* ndaj shtetasve E. P., D. G., e D. B., dhe pas identifikimit të tyre të konkludojë për pozitën procedurale në procedimin penal.

ç.Rasti duhet hetuar në mënyrë të gjithanshme dhe objektive, për të konfirmuar vërtetësinë e deklarimeve të personave të dëmtuar E. P., dhe D. G., dhe sqaruar arsyen pse, pikërisht pas marrjes nga Policia shtetasit dërgohen në urgjencën e spitalit për të marrë ndihmën mjekësore. Po ashtu, sjelljet dhe veprimet arbitrare të Policisë duhet të shikohen dhe në konteks me rrethanat e kryerjes së operacionit për kapjen e personave të dyshuar si autorë, pas vrasjes së kolegut të tyre Ibrahim Basha.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*.

## **REKOMANDOHET**

“Fillimi i hetimit, për veprën penale *“Kryerja e veprimeve arbitrare”*, ndaj punonjësve të policisë të Strukturave të Forcave Speciale Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në dëm të shtetasve E. P., D. G., etj, nga Lazarati, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të dokumenteve të mëposhtme:

- 1.Proces verbal për marrjen e shpjegimeve të ankuesve E. P., D. G., e D. B., datë 30 Qershor 2015.
- 2.Proces verbal i marrjes së shpjegimeve të shtetasve S. P., dhe P. P., datë 30 Qershor 2015.
- 3.Kërkesa për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor të shtetasit E. P., datë 03.07.2015.
- 4.Kërkesë për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor për shtetasin D. G., datë 03.07.2015.
- 5.Akti i ekspertimit mjeko ligjor nr.1298 datë 20.07.2015, për shtetasin E. P.
- 5.Akti i ekspertimit mjeko ligjor nr.1302 datë 20.07.2015, për shtetasin D. G.
- 6.Shkresa “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë Për Krime të Rënda Tiranë datë 03.07.2015, dhe kthimi i përgjigjes datë 21.07.2015.
- 8.Shkresa “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorit të Policisë së Qarkut Gjirokastrë, datë 03.07.2015, dhe kthimi i përgjigjes datë 08.07.2015.
- 9.Shkresa “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, datë 03.07.2015, dhe kthimi i përgjigjes datë 21.07.2015.
- 10.Kartela klinike e pacientit Elton Proko me nr.2019 datë 27.06.2015, e Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë.
- 11.Kartela klinike e pacientit Dervish Gaba nr.2011 datë 26.06.2015, e Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë.
12. Kartela klinike e pacientit Elton Proko nr.2035 datë 28.06.2015, e Spitalit Universitar të Traumës Tiranë.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**